

ASSIST24

KONTRATË ABONIMI VJETOR - PAKETA E PLOTË

15,000 LEKË / 12 MUAJ

OFRUESI

Subjekti	Aldo Novaku	Emri tregtar	ASSIST24
NIPT	M41603031L	Tel.	068 956 7718
Selia	Tiranë, Rruga Çamëria, Pallati 20, Shkalla 4, Kati 0	Web	assist24.al

1. Të dhënat e abonentit

Emër / mbiemër			
Telefon			
Adresa e banimit	Qyteti / Zona / Rruga: Pallati / Banesa: Kati: Dera:		
Automjeti	Marka / Modeli: Targa: VIN: 		
Periudha	Data e fillimit: / / Data e mbarimit: / /		
Lloji i banesës	☐ Apartament ☐ Vilë / Shtëpi private		
Numri i kateve funksionale			
Numri total i tualeteve			
Shtesat	+3,000 lekë/vit kat shtesë pa tualet +6,000 lekë/vit kat shtesë me tualet +3,000 lekë/vit çdo tualet tjetër shtesë		

2. Objekti dhe shërbimet e përfshira

ASSIST24 organizon dhe siguron shërbime hidraulike, elektrike, bravandreqësi, teknik për lavatriçe, televizor dhe kondicioner, si dhe deri në 2 shërbime karrotreci gjatë periudhës 12-mujore. Haku i punës së profesionistëve për këto shërbime përfshihet në abonim.

3. Mbulimi i shërbimit

Shërbimet në banesë vlejnë vetëm për adresën e deklaruar dhe për instalimet ekzistuese. Abonimi mbulon ndërhyrjet për problematika ose defekte konkrete dhe nuk përfshin instalime të reja apo ribërjen e plotë të instalimeve hidraulike ose elektrike të banesës apo të një ambienti të saj.

4. Aktivizimi dhe afati

Abonimi zgjat 12 muaj nga data e aktivizimit. Shërbimi aktivizohet 24 orë pas nënshkrimit të kontratës, përveçse në raste urgjente.

5. Çmimi dhe pagesa

Çmimi total është 15,000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë për 12 muaj.

6. Kontakti 24/7 dhe trajtimi i kërkesës

ASSIST24 ofron mundësi kontakti dhe organizim të shërbimit 24 orë në ditë, 7 ditë në javë. ASSIST24 angazhohet të organizojë ndërhyrjen e profesionistit brenda 72 orëve nga marrja e kërkesës. Në rastet urgjente, kërkesa trajtohet me prioritet dhe ndërhyrja organizohet sa më shpejt të jetë e mundur. Në raste kur natyra e problematikës, vendndodhja ose rrethana të jashtëzakonshme, jashtë kontrollit të ASSIST24, e bëjnë të pamundur respektimin e këtij afati, abonenti njoftohet për kohën e pritshme të ndërhyrjes.

7. Pjesët

Pjesët e nevojshme për riparim ose zëvendësim nuk përfshihen në abonim dhe paguhen veçmas nga abonenti.

8. Bashkëpunimi dhe siguria

Abonenti siguron hyrje të ligjshme dhe të sigurt në ambient. Profesionisti kryen ndërhyrjen për të cilën është dërguar. ASSIST24 nuk zëvendëson shërbimet publike të emergjencës.

9. Karrotreci dhe automjeti

Shërbimi i karrotrecit ofrohet për automjetin e deklaruar nga abonenti dhe të identifikuar me numrin e shasisë (VIN), deri në 2 herë gjatë periudhës 12-mujore. Çdo ndryshim i automjetit duhet të njoftohet paraprakisht.

10. Përfshirjet

Nuk përfshihen kontrole periodike ose preventive pa një problematikë konkrete, punime të reja ndërtimi/rikonstruksioni, pajisje ose pjesë të reja, adresa të padeklaruara. Kur riparimi është i pamundur ose i pasigurt, profesionisti mund të rekomandojë zëvendësim ose ndërhyrje tjetër jashtë abonimit.

11. Cilësia dhe përgjegjësia

ASSIST24 koordinon shërbimin dhe trajtimin e problematikave që lidhen me ndërhyrjen e organizuar. Përgjegjësia vlerësohet sipas ligjit dhe rrethanave konkrete.

12. Përdorimi dhe rinovimi

Nëse abonenti nuk përdor asnjë nga shërbimet e përfshira gjatë gjithë periudhës 12-mujore, abonimi rinovohet pa pagesë për një periudhë të mëtejshme prej 12 muajsh.

13. Mospërbushja dhe përfundimi i parakohshëm

Mospërbushja e detyrimeve dhe përfundimi i parakohshëm trajtohen sipas legjislacionit në fuqi dhe rrethanave konkrete.

14. Forca madhore

Palët nuk mbajnë përgjegjësi për vonesa ose pamundësi të përkohshme të shkaktuara nga rrethana jashtë kontrollit të tyre të arsyeshëm.

15. Heqja dorë nga kontrata në largësi ose jashtë ambienteve

Kur kontrata lidhet në largësi ose jashtë ambienteve të tregtimit dhe abonenti ka statusin e konsumatorit, zbatohet e drejta e heqjes dorë sipas legjislacionit në fuqi.

16. Ankesat dhe njoftimet

Ankesat dhe njoftimet i drejtohen ASSIST24 në kontaktet e shënuara në këtë kontratë.

17. Të dhënat personale

ASSIST24 mbledh dhe përdor vetëm të dhënat e nevojshme për administrimin e abonimit dhe realizimin e shërbimeve. Të dhënat mund t'u komunikohen profesionistëve bashkëpunëtorë vetëm kur është e nevojshme për realizimin e shërbimit dhe trajtohen sipas legjislacionit në fuqi.

18. Ligji, ndryshimet dhe pranimi

Kontrata zbatohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Me nënshkrimin e saj, abonenti konfirmon se është njohur me shërbimet, çmimin, kohëzgjatjen dhe kushtet e abonimit.

NËNSHKRIMET

PËR ASSIST24

Emër / mbiemër: _____

Firma: _____

ABONENTI

Emër / mbiemër: _____

Firma: _____